



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME TË KREUT TË III "MBI KRITERET DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE PËR MARRJEN E LICENCAVE TË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË ARKEOLLOGUT NGA INDIVIDË DHE SHOQËRI PRIVATE" TË RREGULLORES SË MIRATUAR ME VENDIM NR.2 DATË 30.01.2009 TË KKA,

*MIRATUAR ME VENDIM NR. 259, DT. 13.12.2017 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARKEOLOGjisë*

### KREUT TË III

Në mbështetje të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003. "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar) nen 43; të VKM-së Nr. 725, datë 21.05.2008. "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"; Vendimi Nr.2 datë 30.01.2009 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

**Neni 1**  
**Objekti i rregullores, fusha e veprimit dhe qëllimi**

Kjo rregullore bazohet në legjislacionin në fuqi për dhënien e licencave individëve dhe shoqërive dhe shtrin fushën e veprimit në:

1. Organizimin dhe funksionimin e strukturave që merren me procedurat e licencimit të subjekteve për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike.
2. Klasifikimin e punimeve të ekspertizës në fushën e arkeologjisë, kushtet dhe kriteret që duhen plotësuar për t'u pajisur me licencë profesionale.
3. Të drejtat që kanë personat fizikë dhe juridikë për t'u pajisur me licenca për kryerjen e veprimtarisë arkeologjike, detyrimet që ka administrata shtetërore për realizimin dhe trajtimin konform dispozitave ligjore të kërkesave të personave fizikë dhe juridikë.
4. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave për dhënien e licencave në fushën e veprimtarisë arkeologjike në mënyrë që:
  - a) Të krijojë kushtet për parandalimin e gërmimeve të paligjshme arkeologjike; të sigurojë kryerjen në rrugë shkencore të veprimtarive arkeologjike duke përdorur metoda jo shkatërruese, si dhe të sigurojë që elementë të trashëgimisë kulturore të mos lihen të ekspozuara gjatë dhe/ose pas gërmimit, pa u marrë masat e duhura për ruajtjen, konservimin dhe administrimin e tyre.
  - b) Të sigurojë realizimin e veprimtarive arkeologjike vetëm nga persona të kualifikuar dhe të autorizuar posaçërisht për këto veprimtari.
  - c) Të ndalojë gërmimet e paligjshme apo zhvendosjen e artefakteve të trashëgimisë arkeologjike.

**Neni 2**  
**Përkufizimi i termave**

1. “Arkeologji Preventive” është veprimitaria e cila ka si objektiv, të sigurojë në tokë dhe nën ujë zbulimin dhe studimin shkencor të potencialit arkeologjik që mund të dëmtohet nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit.
2. “Arkeologji Shpëtimi” është veprimitaria e cila ka të bëjë me gërmimin, shpëtimin dhe dokumentimin e të dhënavës dhe materialeve arkeologjike, si pasojë e punimeve ndërtuese të çdo natyre, planet e rregullimit të territorit apo faktorë natyrorë.
3. “Veprimitari arkeologjike” është procesi që përfshin vlerësimin e potencialit arkeologjik, përmes vëzhgimit sipërsaqësor (sipas nacionit klasik si dhe metodave të reja për vëzhgimin arkeologjik, si p.sh. studimet, gërmimet arkeologjike dhe me gjedoradar etj), sondazhet arkeologjike, gërmimin arkeologjik, monitorimin, konservimin, administrimin arkeologjik, si dhe përpilimin e dokumentacionit të nxjerrë prej kësaj veprimitarie, raporteve paraprakë dhe përfundimtarë deri në botimin e rezultateve.
4. “Vëzhgimi sipërsaqësor” (Survey arkeologjik) është procesi arkeologjik, nëpërmjet të cilit, mblidhet informacioni që do të hedhë dritë mbi vendndodhjen, shpërndarjen dhe organizimin e aktivitetit njerëzor të së kaluarës.
5. “Sondazh arkeologjik” nënkuption gërmimin që ndërmerret me qëllim ekzaminimin dhe studimin paraprak të karakterit dhe të stratigrafisë së një zone arkeologjike ose me potencial arkeologjik.
6. “Gërmim arkeologjik” është ndërhyrja e plotë në nëntokën arkeologjike. Ai kryhet: sipas mënyrës frontale të avancimit, zgjerimit të sipërsaqes së gërmimit të mëparshëm, ose përmes parcelizimit (copëzimit) të sipërsaqes arkeologjike të diktuar prej hapave paralelë të ndërtimit. Për të gjitha këto raste, secilës njësi arkeologjike që zbulohet, do t’i bëhet prerja, hulumtimi dhe dokumentimi. Ai kryhet nga arkeologu (drejtuesi i gërmimit), tekniku i gërmimit, konservuesi i mjediseve arkeologjike, personeli plotësues teknik (skicograf, fotograf).
- 6.1. “Gërmim arkeologjik shpëtimi” është gërmimi që ndërmerret për shpëtimin e siteve, monumenteve, depozitave arkeologjike, që zbulohen gjatë projekteve zhvillimore, ndërhyrjeve të ndryshme në territor, ose që zbulohen rastësisht gjatë punimeve bujqësore dhe ndërtimore.
7. “Monitorim arkeologjik” përbën në vetvete një program vëzhgimi të kryer gjatë zbatimit të një projekti zhvillimor, brenda një zone të caktuar, në tokë ose nën ujë, ku ekziston mundësia që depozitimet arkeologjike mund të prishen ose të dëmtohen. Ky proces nënkuption praninë e specialistëve arkeologë gjatë zhvillimit të punimeve të projektit deri në përfundim të gërmimeve dhe rezulton me përgatitjen e një raporti dhe arkivimin e të dhënavëve.
8. “Agjencia e Shërbimit Arkeologjik” (ASHA) është institucion qendror, në varësi të

ministrat përgjegjës për trashëgiminë kulturore. ASHA ushtron veprimitari në fushën e gërmimeve, studimeve të trashëgimisë kulturore si dhe gjeljeve rastësore, që preket nga punimet ndërtuese të çdo natyre, apo nga planet për rregullimin e territorit.

9. “Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë” (KKA) është Organ kolegjal i krijuar me Ligjin Nr. 9048, dt. 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i cili funksionon me VKM Nr.725 dt.21.05.2008. “Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të KKA”. Ky organ përbëhet nga 11 anëtarë (përsaqësues të institucioneve të specializuara dhe personalitetë të fushës) dhe teston personat fizikë dhe juridikë për dhënen e licencave profesionale për veprimitarinë arkeologjike.
10. “Licencë për ushtrim profesioni” është akt administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën për të filluar dhe ushtruar tipin e veprimitarisë në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.
11. “Kartelë Shoqëruese e kërkesës” është fletë evidentuese që shoqëron çdo kërkesë me shënimet përkatëse të punonjësve të Sekretarisë teknike të KKA-së nga pranimi deri tek vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA-së).
12. “Vite eksperience profesionale” janë vite ushtrimi aktiviteti profesional në fushat e arkeologjisë, e dokumentuar me referenca apo dokumente ekuivalente, të lëshuara nga persona juridikë publik apo privat, apo persona fizikë, nga momenti i diplomimit në nivelet e përcaktuara, në kriteret specifike të kësaj rregulloreje.
13. “Diplomë” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuar sipas dispozitave në fuqi.
14. “Kategori” është specifikimi i llojit apo nënlojit të veprimitarisë, në fushën e arkeologjisë.
15. "Subjekt" në kuptim të kësaj rregulloreje, është çdo person fizik ose juridik, që ushtron veprimitari në fushën e arkeologjisë.
16. "Shoqëri" është personi juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar (pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit), sipas legjislacionit në fuqi, për ushtrimin e veprimitarisë profesionale në fushën e Arkeologjisë.

### Neni 3

**Organizimi dhe funksionimi i strukturës për dhënen e licencave profesionale për veprimitari arkeologjike.**

1. KKA ushtron veprimitarinë në fushën e arkeologjisë në përputhje me këtë rregullore dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, që përcaktojnë kriteret në këtë fushë.
2. KKA thirret në mbledhje për dhënen e licencave nga Kryetari i tij, Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Kërkesa me dokumentacionin shoqërues dorëzohet pranë Sekretarisë Teknike të KKA-së.
  - ASHA, pasi shqyrton dokumentacionin dhe e konsideron atë të plotë, e përfshin në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme (për dhënien e licencave) të KKA-së.
4. Mbledhjet e KKA-së për dhënien e licencave janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se tre të katërtat e anëtarëve të saj, përfshirë dhe Kryetari i KKA-së.
5. KKA vendos edhe për praktikat e përgatitura nga Sekretaria Teknike që lidhen me kërkesa të subjekteve të karakterit formal, si vijon:
  - a) Ndryshim dhe shtesë në drejtuesit teknik të Shoqërisë;
  - b) Zgjatje të asfatit të vlefshmërisë së licencës.
6. Në mbledhjet e KKA-së mbahet protokoll.

#### **Neni 4** **Përgatitja e materialeve për dhënien e licencave**

1. Rendi i ditës për mbledhjen e KKA-së caktohet nga kryetari i KKA-së në bashkëpunim me Sekretarin e KKA-së, i cili është Drejtori ASHA-s.
2. KKA shqyrton materialin që ka të bëjë me dhënien e licencave individëve /subjekteve, i cili përgatitet nga Sekretaria Teknike e KKA-së (ASHA).
3. Sekretaria Teknike e KKA-së kërkon informacion nga Institucionë shtetërore/private të specializuara për veprimtarinë arkeologjike të personave të cilët kërkojnë të pajisen me licenca. Informacioni paraqitet në materialin për KKA.
4. Materialet që do të shqyrtohen në mbledhje, u shpërndehen pjesëtarëve të KKA-së jo më vonë se tre (3) ditë pune para datës së caktuar për mbledhje.

#### **Neni 5** **Marrja e vendimeve**

1. KKA shqyrton kërkesat e personave dhe subjekteve të interesuar për licencë për veprimtarinë arkeologjike në fushën e arkeologjisë dhe njofton kërkuesit brenda 30 ditëve për miratimin ose jo të kërkesave.
2. Licenca e ushtrimit të profesionit në fushën e arkeologjisë pasi miratohet nga KKA, nënshkruhet nga kryetari, i cili është Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

#### **Neni 6** **Dorëzimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave**

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj sipas kësaj rregulloreje, depozitohen

zyrtarisht pranë Sekretarisë Teknike të KKA-së në ASHA.

2. Çdo kërkesë dhe dokumentacioni shoqëruar sipas kësaj rregullore duhet të jetë në format letër dhe në gjuhën shqipe (Dokumentet e përkthyer duhet të noterizohen).
3. Për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridikzionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistencë e tyre, si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.
4. Çdo kërkesë shqyrtohet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga depozitimi i saj:
  - a) Nëse dokumentacioni i depozituar është në përputhje me këtë rregullore kalon për shqyrtim në mbledhjen e radhës të KKA-së.
  - b) Nëse paraqet mangësi apo pasaktësi në dokumentacion, njostohet me shkrim kërkuesi për mangësitë e dokumentacionit.
5. Në kartelën shoqëruese bëhen shënime dhe pas plotësimit të dokumentacionit ajo nënshkruhet nga specialistët, përgjegjësi i SAST (Sektori i Arkivës dhe Sekretarisë Teknike) si dhe përgjegjësi i SSHAA (Sektori i Shpëtimit Arkeologjik), për të vijuar procedurën për shqyrtim dhe vendimmarrje nga KKA.

**Neni 7**  
**Ruajtja, arkivimi dhe shpërndarja e licencave.**

1. Në bazë të vendimit të KKA-së, përgatitet Licenca në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave pas nënshkrimit të Ministrit, i dorëzohet subjektit përkatës, ndërsa tjetra ruhet për arkivim pranë ASHA-s.
2. Licencat profesionale janë dokumente me vlerë që i nënshtron prodhimit të posaçëm. Formati i tyre propozohet dhe miratohet nga KKA dhe është pjesë e aneksit të kësaj rregulloreje.
3. Sekretaria Teknike arkivon sipas rregullave, licencat dhe të gjithë dokumentacionin duke përfshirë edhe mandatin e arkëtimit për pagesën sipas tarifave përkatëse, përcaktuar në Urdhrin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.
4. Shpërndarja e licencave të interesuarve bëhet jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit. Të interesuarit paraqiten pranë Sekretarisë Teknike të KKA-së.

**Neni 8**  
**Bashkëpunimi me persona juridik publik apo privat**

1. Sekretaria Teknike, mban lidhje të qëndrueshme me institucionet e administratës shtetërore dhe:

- a) kérkon, pranon dhe u jep atyre zyrtarisht informacion pér subjektet që licencohen pranë saj;
- b) trajton dhe u kthen zyrtarisht përgjigje ankesave apo propozimeve të tyre;
- c) kérkon me shkresë zyrtare, verifikimin e saktësisë së vetëdeklarimeve të aplikuesve, apo vërtetësisë së dokumenteve të lëshuara nga institucionet, dhe të paraqitura nga subjektet në procedurat e aplikimit.

2. Sekretaria Teknike ka pér detyrë të informojë çdo kérkues, në lidhje me:

- a) kérkesat e përgjithshme dhe specifike që nevojiten pér të aplikuar pér licencë;
- b) përputhshmërinë e dokumentacionit në lidhje me kérkesat e kësaj rregulloreje;
- c) ecurinë e aplikimit të tij pér licencë;
- c) të dhëna në lidhje me individë, apo shoqëri të licencuara, pér rastet kur kérkuesi vërteton se është i përfshirë në procese ligjore, me subjektin, pér të cilin kérkon informacion.

3. Në rastin kur KKA kérkon informacion pér vërtetësinë e deklarimeve/dokumenteve, Sekretaria Teknike kérkon me shkresë zyrtare, pranë subjekteve private, informacione në lidhje me vërtetësinë e:

- a) referencave të lëshuara nga subjekti privat, të paraqitura nga aplikuesi.
- b) projekteve të hartuara nga subjekte, udhëheqës të këtyre projekteve, të paraqitura nga aplikuesi, si bashkëpjesëmarrës në hartimin e tyre.

### **Neni 9 Protokolli–Registrat–Arkivi**

1. Sekretaria Teknike mban dhe ruan sipas rregullave në fuqi:

- a) protokoll pér evidentimin e kérkesave të subjekteve pér licencë;
- b) regjistër themeltar pér regjistrimin e licencave profesionale personale dhe të shoqërive arkeologjike private;

2. Arkivi i Sekretarisë vendoset pranë ASHA.

### **Neni 10 Licencat profesionale, klasifikimi dhe kategoritë; kushtet dhe kriteret në procedurat e pajisjes me to**

Licenca është dokument juridik profesional që i jep të drejtë poseduesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar sipas klasifikimit dhe kategorive të veprimitarisë arkeologjike.

### **Neni 11 Lloje të licencave dhe klasifikimi i tyre**

- 1. Lloje të licencave janë:**
  - a) Licenca profesionalë individuale për veprimtari arkeologjike
  - b) Licenca profesionalë për shoqëri për veprimtari arkeologjike
- 2. Licencat profesionale personale apo për shoqëri, jepen për këto kategori:**
  - A. Për veprimtari arkeologjike**
    - A1. Vëzhgim arkeologjik (*Survey*)
    - A2. Sondazh dhe Gërmim arkeologjik
  - B. Për veprimtari arkeologjike nënujore**
    - B1. Vëzhgim arkeologjik (*Survey*) nënujor
    - B2. Sondazh dhe Gërmim arkeologjik nënujor
  - C. Licencë për monitorim arkeologjik, gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore.**
- 3. Licenca përmban këta elementë:**
  - a) Të dhëna të individit apo shoqërisë disponues;
  - b) Kategoritë për veprimtaritë që ka të drejtë të ushtrojë disponuesi;
  - c) Afati i vlefshmërisë për rastet e shoqërive;
  - d) Numri i regjistrimit themeltar;
  - e) Shenja dalluese;
  - f) Fotografia e individit për licencat individuale;

### **Neni 12** **Të drejta dhe kufizime në përdorimin e Licencës**

1. Të gjithë subjektet e interesuar dhe që përbushin kriteret e kësaj rregulloreje, mund të pajisen me licencë profesionale.
2. Licenca nuk lejohet të transferohet nga një individ apo shoqëri tek tjetra.
3. Kur subjekti humbet licencën profesionale, njofton menjëherë zyrtarisht Sekretarinë Teknike të KKA-së dhe pajiset me dublikatë, me plotësimin e dokumenteve sipas kategorieve të kësaj rregulloreje.
4. Licencat individuale tërhiqen nga vetë personi i licencuar, ose nga persona të autorizuar për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet).
5. Licencat e shoqërise tërhiqen nga drejtuesi ligjor, ose persona të autorizuar për të kryer një veprim të tillë (kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet), ose nga drejtuesit teknik të shoqërisë.
6. Shoqëritë që janë pajisur me licencë të re, si rezultat i ndryshimit të drejtuesve teknikë, drejtuesve ligjor apo ndryshim të emrit ose selisë, përpëra se të tërheqin licencën duhet të

dorëzojnë origjinalin e licencës paraardhëse. Origjinali shënjohet nga Sekretaria teknike me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit pranë arkivit të Sekretarisë Teknike.

7. Profesionistët që punojnë në institucionet e specializuara si: Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (ASHA), Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtori të Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK), kanë të drejtë të bëjnë kërkesë pranë KKA për licencë. Kjo kategori pajiset me vërtetim për miratimin e licencës. Të drejtën e marrjes së kartonit dhe fillimin e esekteve, e ka vetëm në momentin e shkëputjes së tyre nga puna.
8. Anëtarët e KKA-së mund të pajisen me licencë në fushën e arkeologjisë nëse plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje. Në rastin e procesit të shqyrtimit dhe miratimit të licencës si edhe në prezantimet e projekteve të tyre arkeologjike, ata nuk duhet të janë prezent dhe të marrin pjesë në vendimmarje. Në rastet e siperpërmendura, pjesë e dokumentacionit që shoqëron aplikimet do të jetë edhe një deklaratë e nënshkruar nga ana e anëtarit të KKA-së, lidhur me mospjesëmarrjen e tij në vendimmarje në projektin ku ai është pjesëmarrës dhe kur shqyrtohet aplikimi për licencë. Në çdo rast ata i nënshtronhen ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" (i ndryshuar).
9. Nuk është e vlefshme asnjë lloj licence në fushën e arkeologjisë, dhënë nga institucione të huaja.

#### **Neni 13 Afatet e vlefshmërisë së Licencës**

1. Afatet e vlefshmërisë së licencave nga data e lëshimit të tyre janë:

- a) për licencë profesionale të shoqërive arkeologjike, sa afati i vlefshmërisë së kontratës që ka shoqëria me drejtuesin/drejtuesit teknikë (kontrata me afatin e vlefshmërisë më të afërt) por jo më shumë se 5 vjet;
- b) licencat individuale jepen pa afat.

#### **Neni 14 Kushtet dhe kriteret paraprake për të fituar licencën**

1. Çdo person fizik e juridik ka të drejtë të paraqesë pranë Sekretarisë Teknike të KKA-së, kërkesë (ASHA) për t'u pajisur me licencë profesionale personale ose për shoqëri arkeologjike private, sipas kategorive të përcaktuara, pasi të ketë plotësuar kushtet paraprake që shënohen më poshtë.
2. Të gjitha aplikimet për licenca bëhen me pagesë, sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.
3. Llojet e licencave individuale janë:

- A. Për veprimtari arkeologjike.  
A1- Vëzhgim arkeologjik (Survey)  
A2- Sondazh dhe Gërmim arkeologjik

**B. Për veprimtari arkeologjike nënujore**

B1- Vëzhgim arkeologjik (*Survey*) nënujor

B2- Sondazh dhe Gërmim arkeologjik nënujor

**C. Licencë për monitorim arkeologjik gjatë projekteve zhvillimore**

**4. Arsimi dhe eksperiencia:**

- a. Për të përfituar licencën **A1- Vëzhgim arkeologjik (*Survey*)**, individi duhet të jetë i pajisur me:

- i. Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njojur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, e barasvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.
- ii. Diplomë shkolle pasuniversitare (master shkencor) brenda ose jashtë vendit, të njojur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në arkeologji dhe nëndegët e saj.
- iii. Eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit.

- b. Për të përfituar licencën **A2- Sondazh dhe Gërmim arkeologjik**, individi duhet të jetë i pajisur me:

- i. Grada "Doktor" në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njojur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, për rastet e sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike me karakter studimor.
- ii. Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit e vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit.

- c. Për të përfituar licencën **B1- Vëzhgim arkeologjik (*Survey*) nënujor**, individi duhet të jetë i pajisur me:

- i. Diplomë të shkollës së lartë në fushën histori- arkeologji ose diplomë universitare të huaj, e cila të jetë e njojur nga Ministria përgjegjëse për arsimin e barasvlefshme me diplomën e sipërpërmendur.
- ii. Diplomë shkolle pasuniversitare (master shkencor) brenda dhe jashtë vendit, të njojur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në arkeologji nënujore.
- iii. Gradën e tretë të zhytësit, ose superiore, të mbrojtur me një nga didaktiket e njoitura në të gjithë botën si SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- iv. Personi që do të licencohe duhet të demonstrojë që gjatë punës së tij nën ujë do të jetë gjithmonë i shoqëruar nga të paktën një zhytës me gradën e dytë, ose superiore, të didaktikeve SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme.
- v. Të ketë sigurimin për jetën në standarde Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE.
- vi. Eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 3 (tre) projekte për veprimtari arkeologjike nënujore, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noteruar) nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit.

- d. Për të përsituar licencën B2- Sondazh dhe Gërmim arkeologjik nënujor përveç 5 pikave të para të sipërpërmendura duhet:
  - i. Grada shkencore "Doktor" në fushën e arkeologjisë dhe nëndegët e saj brenda ose jashtë vendit, e njohur nga Ministria përgjegjëse për Arsimin, për rastet e sondazheve dhe gërmimeve arkeologjike me karakter studimor.
  - ii. Eksperiencë si autor dhe/ose bashkautor në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga dokument i konfirmuar (origjinal ose i noterizuar) nga institucioni apo drejtuesi teknik.
- e. Për të përsituar licencën C- Licencë për monitorim arkeologjik gjatë projekteve zhvillimore, individi duhet të plotësojë këto kushte:
  - i. Diplomë në bachelor në arkeologji ose master në arkeologji dhe në fushën e trashëgimisë kulturore brenda ose jashtë vendit, e njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin.
  - ii. Eksperiencë të paktën 3 vjeçare në arkeologji, gjatë së cilës të ketë marrë pjesë në të paktën 3 (tre) projekte arkeologjike brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar (kopje e projektit ose raportit përfundimtar të depozituar) në institucionin që ka dhënë miratimin.

#### **Neni 15 Kriteret për licencimin e Shoqërisë Arkeologjike**

1. Të ketë të paktën një drejtues teknik të licencuar, i cili të jetë pajisur përkatësisht me licencë A1/ A2, / B1/ B2, / C.
2. Në rast të paraqitjes së koncepteve për ndërhyrjet arkeologjike, pjesë të dokumentacionit të nevojshëm është përbërja e grupit të punës.  
Në grupin e punës duhet të përfshihen domosdoshmërisht, përveç arkeologëve të diplomuar në fushat e përmendura në Nenin 13, edhe:
  - a) një arkeolog-konservues/konservues, i cili duhet të jetë i pajisur me Diplomë shkolle pasuniversitare (master shkencor) për arkeologjinë brenda ose jashtë vendit, të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në arkeologji dhe nëndegët e saj, si dhe të ketë eksperiencë, ose të ketë kryer specializime që lidhen me konservimin arkeologjik;
  - b) gjeoded
  - c) skicograf;
  - d) arkitekt;

#### **Neni 16 Detyrat dhe të drejtat e subjekteve të licencuar**

1. Të jenë regjistruar si subjekt juridik sipas dispozitave ligjore për të ushtruar veprimitari në fushën e arkeologjisë.

2. Të ketë drejtues teknik një ose më shumë persona fizikë të pajisur me licencë profesionale personale në fushën e arkeologjisë;
3. Shoqëritë duhet të kenë statusin “aktiv” të ushtrimit të veprimtarisë, dëshmuar nga dokumenti i QKR-së.
4. Të njoħe dhe tē kryejë veprimtari nē pērputħje me aktet ligjore e nēnligjore nē fushën e trashëgimisë kulturore.
5. Tē njoħe dhe tē zbatojë nē veprimtarinē e tij rregullat e sigurimit teknik nē punē.
6. Ćdo shoqëri e licencuar nuk duhet tē ushtrojë asnjë veprimtari tē papērcaktuar nē planet ditore nga drejtuesi teknik.
7. Drejtuesi teknik i projektit nuk mund tē ushtrojë njékohësish veprimtarinē e tij si i tillé nē më shumë se një shoqëri.
8. Nē rast se drejtuesi teknik shkëput marrēdhëniet e punēs me shoqërinē, njofton menjëherë zyrtarisht sekretarinē tekniqe tē KKA-së, e cila e dërgon pēr shiqyrim nē KKA.

**Neni 17**  
**Dokumentet që shoqerojnë kérkesën pēr licencë profesionale**

Kérkesa pēr licenca profesionale individuale duhet tē pērmbajë dhe shoqérohet me:

1. Kérkesë me shkrim nē formē autobiografie tekniqe (Curriculum Vitae) me tē dhëna kryesore:
  - a) Emri, atësia, mbiemri, kopje tē kartës së identitetit, vendlindja, adresa, vendi i punēs, numri i telefonit dhe dy kopje fotografish 3x4cm.
  - b) Llojet e veprimtarisë që kérkon tē kryejë, sipas kategorive dhe llojeve tē pērcaktuara.
2. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, pēr pajisje me licencë profesionale individuale sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.
3. Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij nē lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, pēr probleme nē ushtrimin e veprimtarisë profesionale ku kérkon tē licencoitet, si dhe mbi angazhimin pēr tē njoħur e zbatuar nē veprimtarinē e tij legìslacionin nē lidhje me trashëgiminë kulturore.
4. Veprimtaria e kryer nga marrja e diplomës deri nē momentin e kérkesës, vërtetuar nga institucionet pērkatëse.
5. Kopje e diplomës e noterizuar.
6. Kualifikimet apo specializimet dhe kontributet tē veċanta nēpērmjet certifikatave tē lëshuara

nga organet kompetente, të noterizuara.

### Neni 18

#### Për pajisjen me dublikatë të licencës individuale (Akt formal pa miratim në KKA)

Aplikimi për pajisje me dublikatë të licencës individuale, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

1. Kërkesë me shkrim, ku të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet, dhe arsyet e kërkesës për dublikatë, shoqëruar me:
  - a) Dy fotografji për dokument të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit).
  - b) Kopje të licencës së mëparshme të individit.

### Neni 19

#### Dokumentet që shoqërojnë kërkesën për licencimin e Shoqërise Arkeologjike

Kërkesa për licenca profesionale për shoqëri arkeologjike, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, duhet të shoqërohet me:

1. Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum Vitae) e drejtuesit ligjor të shoqërisë apo përfaqësuesit juridik të tij, me të dhëna kryesore të drejtuesit ligjor e teknik të shoqërisë:
  - a) Emri, atësia, mbiemri, kopje e kartës së identitetit, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit i drejtuesit ligjor dhe teknik të shoqërisë.
  - b) Veprimitaria që do të kryejë shoqëria, sipas kategorive dhe llojeve të përcaktuara në licencën profesionale të drejtuesit teknik për veprimitari arkeologjike.
2. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale për Shoqëri arkeologjike sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.
3. Kopje të ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (dokument i jo më parë se 1 muaj nga aplikimi).
4. Kontrata midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, e hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).
5. Vetëdeklarim i drejtuesit ligjor mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimitarisë ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin për të njojur e zbatuar në veprimtarinë e shoqërisë të gjitha ligjet në fuqi në fushën e trashëgimisë kulturore.
6. Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë mbi:

- a) gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;
- b) se nuk është drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
- c) se nuk është në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura;
- d) se do të zbatojë në veprimtarinë e shoqërisë, parimet e kërkimit arkeologjik, rregullat e sigurimit teknik në punë dhe aktet ligjore e nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Përjashtohen nga kushtet e pikës 6/c individët që ushtrojnë funksione në zbatim të ligjit "Për arsimin e lartë".

7. Kopje të Licencës individualitetë drejtuesit teknik të projektit.

8. Vetëdeklarim i drejtuesit ligjor se disponon ambiente të sigurta të mbrojtura 24 orë, apo të survejuara nga kamera sigurie, për depozitimin e gjetjeve të luajtshme arkeologjike, shoqëruar me foto të këtyre ambienteve.

#### Neni 20

**Për zgjatjen e afatit të licencës së shoqërisë apo dublikatë  
(Kërkesa për dublikatë është Akt formal pa miratim në KKA)**

Aplikimi për zgjatjen e afatit të licencës ekzistuese të shoqërisë (pa kërkuar ndryshime apo shtesa në drejtuesit teknik të shoqërisë), pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me:

1. Kërkesë me shkrim të drejtuesit ligjor të shoqërisë, e cila kërkon zgjatje të afatit të licencës. Për rastet kur kërkohet dublikatë, të përcaktohen të dhënat e licencës që kërkon të dublohet.

2. Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit), për rastet kur kontratave të depozituara më parë u ka kaluar afati i vlefshmërisë.

3. Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë mbi:

- a) gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është kontraktuar;
- b) se nuk është drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
- c) se nuk është në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura;

Përjashtohen nga kushtet e pikës 3/c individët që ushtrojnë funksione në zbatim të ligjit "Për arsimin e lartë".

**Neni 21**  
**Për ndryshim ose shtesa të drejtuesit/drejtuesve teknikë**

Ndryshimi ose shtesa të drejtuesit teknik të shoqërisë, miratohet nga KKA. Aplikimi për të, pasi të plotësohen kusizimet dhe kushtet paraprake të specifikuara në këtë rregullore, shoqërohet me :

1. Kërkesë me shkrim e drejtuesit ligjor të shoqërisë, ku të përcaktohen të paktën të dhënat e licencës së disponuar më parë dhe drejtues/drejtuesit teknikë që do të largohen, si edhe ata që do të shtohen.
2. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale për Shoqëri arkeologjike sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.
3. Kërkesë me shkrim nga drejtuesi teknik i shoqërisë për largimin.
4. Kopje të licencës së drejtuesit apo drejtuesve teknikë që shtohen në shoqëri.
5. Kontratat midis drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të ri, të hartuara përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit).
6. Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve të rinj teknikë mbi:
  - a) gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës për probleme në ushtrimin e veprimitarës për të cilën është kontraktuar;
  - b) se nuk është drejtues teknik në shoqëri të tjera që ushtrojnë veprimitari në fushën e arkeologjisë;
  - c) se nuk është në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore apo të pavarura;

Përjashtohen nga kushtet e pikës 6/c individët që ushtrojnë funksione në zbatim të ligjit "Për arsimin e lartë".

**Neni 22**  
**Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë, çregjistrimi**

Aplikimi për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë në lidhje me veprimitarinë arkeologjike, paraqitet zyrtarisht pranë Sekretarisë Teknike të KKA dhe shoqërohet me:

1. Njoftim me shkrim, nga drejtuesi ligjor, për mbylljen e aktivitetit;
2. Dorëzimin e licencës/licencave që disponon.

**Neni 23**  
**Regjistrimi i licencave profesionale dhe shoqërive**

Tarifat për regjistrim janë të përcaktuara sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 përkatësisht për:

1. Licencë Individuale
2. Licencë për Shoqëri Arkeologjike

**Neni 24**  
**Regjistrimi i Licencave profesionale**

1. Licenca e miratuar nga KKA hartohet në dy kopje origjinale dhe regjistrohet në Regjistrin e Sekretarisë Teknike (ASHA) si dhe Registrat Themeltarë të Licencave Profesionale Personale dhe të Shoqërive.
2. Regjistrat janë dokumente, në përgjegjësi të Sekretarisë Teknike, ku regjistrohen të dhënat e licencave të subjekteve, sa herë ato trajtohen dhe u miratohet licenca, si dhe pasqyrohen të paktën parametrat:
  - a) emërtimi i subjektit të licencuar;
  - b) numri dhe data e vendimit në të cilin është miratuar licenca e subjektit;
  - c) numri i licencës;
  - d) kategoritë e miratuarë;
  - e) afati i vlefshmërisë.
3. Regjistrimet duhet të jenë të sakta, të qarta, pa korrigjime, me vijueshmërinë e numrit rendor dhe pa shkurtime; në regjistrat themeltarë të regjistrimit nuk lejohet të fshihet asgjë. Rregullimet bëhen me numër rendor të ri me fraksion. Një kopje origjinale e licencës, së bashku me praktikën e sjellë nga kërkuesi, mbahet në arkivën e Sekretarisë Teknike. Regjistrimi i licencave profesionale dhe ruajtja e tyre bëhet në bazë të ligjit për arkivat.
4. Të dhënat përditësohen në përputhje me ndryshimet që licencat pësojnë si rezultat i aplikimeve, miratimeve apo penaliteteve.
5. Regjistrat janë dokumente publikë, të cilët janë në përgjegjësi të Sekretarisë Teknike. Ata publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe u mundësohet aksesi në to, çdo enti publik apo privat.

**Neni 25**  
**Sanksione dhe pezullimi i përkohshëm apo heqja e licencës**

Heqja e të drejtës për ushtrimin e aktivitetit apo pezullimin e përkohshëm të aktivitetit profesional arkeologjik të subjekteve të licencuar, është kompetencë e KKA.

1. Rastet kur pezullohet licenca janë:
  - a) Subjekti i licencuar nuk plotëson detyrimet që rrjedhin nga kjo rregullore.

- b) Kur Shoqëria kryen veprimitari arkeologjike pa praninë e drejtuesit të projektit ose në kundërshtim me planet ditore të parashikuara dhe përcaktuara prej tij.
- c) Ka propozim të motivuar nga institucione shtetërore (IA, DRKK, ASHA, Zyra të Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjikë (ZAKPA), Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar/Lokal, Organet e Qeverisjes Vendore, Tatim-Taksave, Doganave), për shkeljen e ligjshmërisë apo kritereve gjatë kryerjes së veprimitarive arkeologjike, që janë në proces apo të kryera më parë.
- d) Kur subjekti i licencuar në arkeologji nuk zbaton vendimin e KKA-së në lidhje me konceptin e kryerjes së sondazheve/gërmimit dhe devijon nga kriteret dhe standartet e miratuar nga KKA mbi veprimitaritë arkeologjike.
- e) Nuk publikon rezultatet e projektit brenda kohës së përcaktuar në kontratë apo nuk i përbahet kritereve të vendosura nga KKA.

**2. Rastet kur hiqet licenca janë:**

- a) Konstatohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme apo dokumente të pavërteta;
- b) Nuk plotëson kriteret e ruajtjes së objekteve/strukturave/ materialit arkeologjik të nxjerra gjatë gërmimit/ vëzhgimit sipërsaqësor.
- c) Kur subjekti fillon sondazhin ose gërmimin pa marrë më parë miratim nga KKA.
- d) Çdo shkelje e parashikuar në nenin 49, të Ligjit "Për trashëgiminë Kulturore"

**3. Për çdo rast hartohet një raport vlerësimi nga një grup pune i ngritur nga KKA i cili, mbikqyr dhe kontrollon mbarëvajtjen e projekteve arkeologjikë të ndërmarrë nga shoqëritë e pajisura me leje. Raporti dörözohet pranë Sekretarisë Teknike të KKA-së dhe, çështja kalon për shqyrtim në mbledhjen e radhës së KKA-së ku merret vendimi përkatës.**

**4. Licenca personale profesionale konsiderohet e pavlefshme kur mbajtësi i saj humbet jetën.**

**Neni 26  
Ankimimi**

Për çdo vendim në zbatim të kësaj rregulloreje, individët dhe shoqëritë kanë të drejtën e ankimimit, sipas dispozitave ligjore, parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative, pranë Gjykatës Administrative Tiranë.

**Neni 27  
Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë, pas miratimit nga KKA. Të gjitha aplikimet për licencë, të cilat nuk kanë marrë ende vendim nga KKA, do të shqyrtohen sipas kësaj rregulloreje.
2. Individët e licencuar në arkeologji, të cilëve u është miratuar licenca nga KKA përparrë hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, kanë 12 muaj kohë për t'u drejtuar KKA-së për

rinovim dhe rikategorizim të licencave, sipas kushteve të parashikuara nga kjo rregullore. Të gjithë individët, të pajisur më parë me licencë individuale "A1" dhe "A2", marrin automatikisht edhe licencën "C", kushtet kualifikuese të së cilës përfshihen në dy kategoritë e sipërpërmendura. Kjo kategori përjashtohet nga detyrimi i kryerjes së pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale dhe tarifës për regjistrim, sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.

3. Shoqëritë e Licencuara në Arkeologji, të cilave u është miratuar licenca nga KKA përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregullore janë të detyruara për t'iu drejtuar KKA-së në të njëjtën kohë me drejtuesin teknik për rinovimin dhe rikategorizimin e licencave sipas kushteve të parashikuara në këtë rregullore. Ato marrin automatikisht kategoritë përkatëse të rinovuara dhe rikategorizuara të drejtuesit teknik.

Kjo kategori përjashtohet nga detyrimi i kryerjes së pagesës së tarifës për pajisje me licencë profesionale dhe tarifës për regjistrim, sipas Urdhërit të Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

ANËTARËT E GRUPIT TË PUNËS TË NGRITUR ME URDHËRIN E MINISTRIT  
TË KULTURËS NR. 17, DATË 22.01.2016

Znj. *Rudina Zoto* - Drejtor i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik

Znj. *Risena Xhaja* - Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria Përgjithëshme e  
Shërbimeve Mbështetëse në MK

Znj. *Kozeta Angjeliu* - Drejtor, DTKMM në MK, Anëtar i KKA

Z. *Luan Përzhita* - Drejtor, Instituti i Arkeologjisë/QSA, Anëtar i KKA

Znj. *Iris Pojani* - Petagog, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji  
Anëtar i KKA

Z. *Lorenc Bejko* - Petagog, Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji  
Anëtar i KKA